

Të nderuar pjesëmarrës,

Përkujtojmë sot me respekt të thellë jetën dhe veprën e një prej shkencëtareve me elitarë të vendit tonë, kolosit të studimeve hidrologjike me vlerë për gjithë Ballkanin dhe me tej, një prej bashkëpunëtorëve më të vjetër të institucioneve të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Prof. Dr. Niko Pano.

I larguar pak ditë më parë nga jeta, të dashurit, vlerësuesit dhe admiruesit e shumtë të punës së tij në hapësirën shqiptare, Profesor Pano lë një trashëgimi jashtëzakonisht të pasur studimesh, botimesh, monografish, profilesh, referatesh, kumtesash e artikujsh me vlera të spikatura jo vetëm shkencore, por edhe praktike për ekonominë hidrike të Shqipërisë, burimit të pashtershëm të mirëqenies së sotme dhe të nesërme të shqiptareve. Përmes studimeve të tij të shumta spikatin 6 studime të emërtesës së Këshillit të Ministrave.

Prof. Pano është autor i Monografisë "Pasuritë Ujore të Shqipërisë", botim i Akademisë së Shkencave, viti 2008, një nga studimet më të plota e madhore të shkencës së sotme shqiptare, fryt hulumtimesh të shtrira në disa dekada. Sikur vetëm këtë punim të kishte përfunduar Profesori, ai do të mbetej me merita të shquara në panteonin e figurave me të larta të shkencës dhe kulturës sonë.

Studimi përfshin tërësinë e resurseve ujore të rrjetit hidrografik të Shqipërisë: lumenjtë, liqenet, ujërat nëntokësore dhe burimet e tyre, si dhe hapësirat bregdetare shqiptare të deteve Adriatik dhe Jon. Mbi këtë bazë, ky punim ka realizuar tipizimin dhe rajonizimin e pasurive ujore të këtij rrjeti. Spektri i gjerë i studimit dhe vlerësimi tërësor i potencialit ujor të Shqipërisë e bën këtë monografi një punim madhor shkencor për një nga pasuritë natyrore më thelbësore dhe jetësore të vendit tonë, siç është uji. Botimi përfaqëson një studim madhor të munguar, i përditësuar e prezantuar në një formë të tillë të plotë e gjithëpërfshirës për gjithë pasuritë ujore të Shqipërisë. Në botim analizohen të gjitha të dhënat faktike shumëvjeçare mbi rrjetin hidrografik të Shqipërisë, që dispononte Instituti i Hidrometeorologjisë ndër vite, të cilat Profesor Pano i përpunoi me shumë dashuri, përkushtim dhe profesionalizëm. Ai i analizoi, interpretoi dhe i përgjithësoi me vërtetësi shkencore rezultatet e këtyre të dhënave, bazuar në teknologjitë dhe metodologjitë bashkëkohore.

Prof. Niko Pano u lind më 16 shtator 1937 në Vlorë, ku kreu edhe shkollën e mesme. Ndoqi studimet e larta në Universitetin e Odesës dhe në vitin e fundit u diplomua në Institutin e Hidrometeorologjisë më 1960 në Leningrad, sot Shën Petërburg. Filloi punën në Institutin e Hidrometeorologjisë së Akademisë së Shkencave si inxhinier hidrolog duke pasur edhe detyra shkencore e drejtuese, si përgjegjës i sektorit të hidrologjisë (1960–1986), nëndrejtor i Institutit Hidrometeorologjik (1990–1992). Prof. Pano shërbeu me pasion si pedagog i jashtëm i lëndës së hidrologjisë në degën e gjeografisë të Universitetit të Tiranës.

Njeri me virtyte të rralla, ai shquhej si organizator dhe njëkohësisht hulumtues i palodhur, gjithnjë i qeshur, i dashur dhe komunikues me koleget. Ishte përherë i zënë me punë dhe me dëshirë të pashtershme për të ndihmuar. Si Kryetar i Shoqatës "Mbrojtja dhe Ruajtja e Ujërave të Shqipërisë", ai dha një kontribut të shquar.

Krahas Kryeveprës së tij, monografisë "Pasuritë Ujore të Shqipërisë", ai është bashkautor i monografisë "Ngjarjet e jashtëzakonshme atmosferike në Shqipëri" (viti 1967); autor i studimit

“Ligjshmëria e depërtimit të ujërave të detit Jon në Adriatik” (1973); i punimeve “Hidrologjia e Shqipërisë” (1984); “Gjeografia Fizike e Shqipërisë” (1990), etj.

Profesor Niko Pano nuk u mjaftua me botime dinjitoze të hulumtimeve të tij të gjera shkencore, por dha kontribut konkret për të ardhmen e ekonomisë së vendit. Ai është autor i Mega-Projektit të HEC të Skavicës në lumin Drini i Zi, viti 2010. Me ndërtimin e Hidrocentralit të Skavicës, të projektuar nga ky kolos i shkencës së hidrologjisë shqiptare, kaskada e Drinit do të prodhojë më shumë energji elektrike si pasojë e rregullimit të plotë me liqenin e Skavicës. Gjithashtu hidrocentralet e Drinit nuk do të shkaktojnë më dëmet dhe përmytjet nga shkarkimet e sforcuara.

Me një kontribut shumë përmasor të shtrire ndër vite, Prof. Pano është autor i studimeve hidrologjike rajonale për sistemin hidrografik “Liqeni i Prespës – Liqeni i Ohrit Lumi Drini i Zi”, si dhe për sistemin hidrografik: “Lumi Drin – Liqeni i Shkodrës – Lumi Buna, Delta e Lumit Buna në detin Adriatik”, gjatë viteve 2008 – 2013. Rrjeti hidrografik i lumit Drin shquhet për individualitetin e tij të veçantë dhe të përsosur natyror, si dhe për potencialin e lartë dhe të shumëllojshëm hidrik. Këtë potencial Prof. Pano ka ditur ta evidentojë, duke i paraprirë planeve për zhvillimet ekonomike të vendit tonë si për të tashmen, ashtu edhe për perspektivën.

Më 1984, Prof. Dr. Niko Pano, për meritat e spikatura të tij, dekorohet nga Kuvendi Popullor me urdhrin “Naim Frashëri” e më pas me “Medalje Pune” me motivacionin “Për arritje të mira në studimet shkencore hidrologjike për vlerësimin e pasurive ujore të Shqipërisë”.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë, për punën e tij me pasion dhe me cilësi, e ka vlerësuar në vitin 2015 me medaljen “Nderi i Akademisë”, me motivacion *“Për kontributin e shquar në shërbimin hidrometeorologjik, në realizimin e kërkimeve e botimeve në fushën të pasurive ujore të Shqipërisë, si dhe atë në fushën e arsimit e të edukimit të brezave të rinj e specialistëve”*.

Gjithashtu, për monografinë shkencore “Pasuritë ujore të Shqipërisë”, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, në kuadër të edicionit të parë të Çmimeve Shkencore të Akademisë për vitin 2016 për studimet dhe botimet më të arrira, Prof. Pano u vlerësua me çmimin shkencor “Radovicka”, me motivacionin *“Vepra shkencore ‘Pasuritë ujore të Shqipërisë’, një studim i gjerë dhe kompleks, është rezultat i kërkimeve gjysmëshekullore për resurset hidrike të Shqipërisë, të realizuar me metoda bashkëkohore, me kontribut të shquar për shërbimin hidrometeorologjik në fushën e pasurive ujore të Shqipërisë me ndikim teorik e praktik në kërkim-zhvillim, si dhe në fushën e arsimit e të edukimit të kërkuesve të rinj”*.

Prof. Niko Pano deri në ditët e fundit të jetës së tij, ka punuar për daljen në dritë të botimit të ri shkencor *“Hapësira bregdetare Divjakë – Karavasta në Adriatik”*, për të cilin në krye të një grupi specialistësh, ai kontribuoi me zellin, gatishmërinë dhe entuziazmin që e karakterizonin, për të paraqitur një studim integral të zonës me qëllim final rikuperimin mjedisor dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik-shoqëror të kësaj hapësire me rëndësi dhe me bukuri të rrallë natyrore.

Me Prof. Niko Panon, personalisht ruaj kujtimet e një bashkëpunimi të shkëlqyer me Kontrollin e Lartë të Shtetit. Për këtë bashkëpunim, unë dhe të gjithë audituesit e KLSH i jemi mirënjohës gatishmërisë së tij të jashtëzakonshme për të ndihmuar, personalitetit, veprës dhe kujtimet të Prof. Dr. Niko Panos.

Dua te ndaj me ju se një nga vlerat dhe risitë më domethënëse te Konferencës se IV-t Shkencore te KLSH “Mbi Analizën e Riskut”, zhvilluar ne datat 20-23 qershor 2016, ishte punimi i Prof. Dr. Niko Panos, Prof. Dr. Gudar Beqirajt dhe Prof. Dr. Salvador Bushatit “Mbi efektet mjedisore dhe ekonomike që shkakton veprimtaria njerëzore në sistemin liqenor të Prespës”. Ky sistem përbën një komponent të rëndësishëm hidrik të Kaskadës Hidroenergjetike të lumit Drin, respektivisht për 2 hidrocentrale të ndërtuar në Maqedoni (Glloboshica dhe Spile) si dhe 4 hidrocentrale të ndërtuara në Shqipëri (Fierzë, Koman, Vau i Dejës dhe Ashta). Punimi u përshëndet nga Eurodeputeti, Dr.Igor Šoltes, i cili tha se kjo kumtesë do të trajtohet nga Parlamenti European në një forum që do të ketë në fokus lumenjtë e Ballkanit. Me kujtohet si tani përshënditja e syve te Prof. Panos ne momentin e dhënies se këtij vlerësimi. Dhe kujtoj po ashtu kontributin e tij si Anëtar i Komisioneve Ndërkombëtare për Hidro-ekonominë Shqipëri – Maqedoni dhe Shqipëri – Mali i Zi, ne vitet 1970 – 1985.

Profesori la një trashëgimi të pasur me vlera shkencore dhe praktike për shkencën dhe ekonominë e vendit tone, duke u shndërruar ne një nga figurat me te spikatura te komunitetit shkencor e universitar mbarëshqiptar. Ai mbetet po ashtu një shëmbëlltyre e kredos morale dhe shkencore me te arrire, e personalitetit te një punëtori te palodhur, dijetari dhe njeriu te jashtëzakonshëm. E kujtojmë sot me shume mall, respekt, nderim dhe mirënjohje këtë Banor te Panteonit te Përrjetshëm te shkencës dhe kulturës shqiptare.

Mbështetur në punën dhe veprën e Prof.Dr.Niko Pano i kam propozuar sot Presidentit të Republikës, SH.T.Z Ilir Meta që profesorit të nderuar ti akordohet titulli “*Kalorës i urdhrit të Skënderbeut*”.

Ju faleminderit!